



VENDIM

Nr. 8, Datë 27.01.2016

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM” SH.A., NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, gërma “c”, nenit 75, të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror ” si dhe neneve 4, pika 1, gërma “c”; 8; 9 pika 1 dhe pika 2, gërma “f” dhe nenin 10; 11; 12 të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria PHOENIX PETROLEUM sh.a si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë PHOENIX PETROLEUM sh.a.

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë PHOENIX PETROLEUM sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *Rregullat dhe Procedurat për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror*”si më poshtë:

- Formati dhe Dokumentacioni për Aplikim, (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni Ligjor, Administrativ dhe Pronësor, (neni 9, pika 1, gërmat d/i; d/ii ; d/v; d/V; d/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale, (neni 9, pika 1, gërma e/i; e/ii; e/iii; e/v; e/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumente specifike për llojin e licensës, (neni 9, pika 2, germa f/i; germa f/ii ;f/iii) plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “PHOENIX PETROLEUM” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, për një periudhë 10 (dhjete) vjeçare.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.